

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

Procesverbal për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës së prokurimit në lote me objekt “Materiale për rrjetin e ndriçimit Unaza e Madhe”

I mbajtur sot në datë 03.04.2024 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt “Materiale për rrjetin e ndriçimit Unaza e Madhe” me fondi limit **67,227,080 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e dyqind e njëzet e shtatë mijë e tetëdhjetë)** pa tvsh,.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote **sa herë kjo është e mundur**. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsyet e mëposhtme:

Së pari, kemi të bëjmë me të njëjtën lloj mallrash, pra me natyrë të njëjtë, që në thelb i përkasin të njëjtës kategori dhe janë në funksion të njëra tjetrës dhe nuk mund të instalohen të ndara.

Së dyti, Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen një nga objektet kryesore dhe të rëndësishme të veprimtarisë së saj, mirëmbajtjen dhe vendosjen e ndriçimit publik në të gjithë territorin e Bashkisë së Tiranës. Në funksion të kësaj veprimtarie AK-ja kërkon që furnizimet të jenë të mundura në cdo moment kur materialet e ndriçimit janë të nevojshme dhe pa vonesa në furnizimin e tyre, krijimi i marrëdhënies kontraktore me disa operatorë ekonomikë, ku AK-së do ti duhet të presë furnizimin e njërit mall nga njëri operator dhe furnizimin e mallit tjetër nga operatori tjetër, sipas loteve, ofron pasiguri, konfuzion, kosto shtesë, vonesa duke vështirësuar në ushtrimin e detyrave të AK-së apo mosrealizim të punëve sipas objektivave.

Së treti, theksojmë se marrëveshja kuadër me disa OE ku jo të gjitha kushtet janë të percaktuara nuk konsiderohet kontratë. Kjo do të thotë që AK-ja nuk kanë mekanizma detyruese për OE të shpallur të suksesshëm për pjesëmarjen e tyre në minikonkurse dhe rrjedhimisht në lidhjen e kontratave pas zhvillimit të tyre. Pasiguria dhe vonesat mund të sjellin dështim në furnizim, duke patur impakt direkt në veprimtarinë e AK-së.

Si përfundim, me qëllim garantimin e furnizimit në afatet kohore të percaktuara, MK me një OE të vetëm fitues do të garantonte sigurinë e furnizimeve sipas kushteve të percaktuara dhe brenda afateve të kërkuara duke sjellë stabilitet në menaxhimin e kontratave dhe të nevojave të AK.

Si përfundim, për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, kjo procedurë për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi si dhe referuar faktit se kemi të bëjmë me të njëjtën natyrë mallrash gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë, në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, që do të shoqërohej me mirëorganizimin e operatorit për sigurimin e mallit në kohë sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së.

NJËSIA E PROKURIMIT